




Pranuar / Doretuar Primljeno/Prodato Received/Delivery	16-01	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHCK	404/2023		118	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1095/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1095/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.1095/2022 e datës 02.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me Nr.148/2022 i datës 10.11.2022 i Zëvendësueses të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Arsyetim

Ankuesi më datë 02.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7601/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.148/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli më datë 13.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7601/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.148/2022 të datës 10.11.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Akt Emërimit Nr.07/2020 i datës 02.07.2020; Akt Emërimit e datës 01.02.2012; Rekomandimin e datës 21.12.2020 nga Komisioni për Gradë dhe Disiplinë; Vendimin me Nr. Ref: 264/2020 i datës 05.07.2020; Vërtetim për periudhën e punë i datës 19.02.2016; Vërtetimin e datës 06.09.2021; Vërtetimin me Nr. 88/2021 të datës 06.09.2021; Kërkesë për informim rreth pozitës Drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike e datës 13.06.2022 e parashtruar nga ankuesi; Rikujtim i datës 18.07.2022 nga përfaqësuesi i ankuesit; Emailin e datës 28.07.2022 nga për S.LAW; Emailin e përfaqësuesit të ankuesit e datës 03.08.2022 për , Emailin e datës 29.04.2020 nga ankuesi për Emailin e datës 26.04.2022 nga ankuesi për . Emailin e datës 24.03.2022 nga ankuesi për Formularin e vlerësimit për nëpunësit të shërbimit të jashtëm për vitin 2020 i datës 03.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.12.2018, 29.12.2017, 26.12.2019; Certifikatën për ankuesin e datës 09.12.2014; Licencën me Nr.06/2014 e datës 02.12.2014; Mirënjohje për ankuesin nëntor 2013; Certifikatën për ankuesin maj 2013; Certifikatë për ankuesin e datës 04.05.2015; Certifikatë për ankuesin e datës 30.06.2012; Diplomën me Nr.05413 e datës 11.10.2013; Diplomën me Nr. 3011 e datës 10.07.2012; Certifikatën e ankuesit e datës 20.04.2010; Certifikatën për ankuesin e vitit 2005; Certifikatën për ankuesin mars 2005; Certifikatën për ankuesin për periudhën 28.06-01.07.2005; Certifikatën për ankuesin e vitit 2006; Certifikatën për periudhën 25-29.03.2013; Certifikatë për periudhën 11-15.04.2011; Certifikatën për periudhën 29.04-25.05.2005; Certifikatën për periudhën 25-27.09.2002; Certifikatën për periudhën 13-27.09.2004; Certifikatën mars 2003; Certifikatën e datës 17.11.2003; Letër motivimin e datës 06.09.2021; Licencën me Nr.VP-01 e datës 20.09.2015; Certifikatën për periudhën 12.11-10.12.2004; Certifikatën për përudhën 14.01-25.02.2005; Certifikatën për periudhën 11.03.-15.04.2005; Certifikatën për periudhën 19.08-09.09.2002; Autorizimin e datës 10.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7846/2022 të datës 09.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7955/2022 e datës 13.12.2022; Raportin e Veçantë të Komisionit të Ristrukturimit me numër protokolli 1620 i datës 01.11.2022; Konkursi me Nr.Reference RN00006214 për pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm; Përshkrimi i detyrave të punës për Drejtor i Drejtorisë së Administratës në AUV i datës 05.11.2013; Akt Emërimit Nr.52/2022 të datës 13.06.2022 për , Vendimit me Nr. Ref: 400/2021 të datës 15.10.2021 Vendimit me Nr. Ref: 199/2021 të datës 11.10.2021; Akt Emërimit AE.Nr.22/2021 të datës 01.04.2021 për Vendimin me Nr. Ref: 100/2015 I datës 30.12.2015; Vendimin me Nr. Ref: 063/2015 të datës 30.12.2015; Vendimit me Nr. Ref: 45/2021 të datës 23.06.2021; Vendimin me Nr. 332/2020 të datës 10.07.2020; Vendimin me Nr. 119/2020 të datës 30.05.2020; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit Nr.017/20215 për , Vendimin me Nr. MPJ-ZSP/198/2014 të datës 15.12.2014; Vendimin me Nr. 004/2013 I datës 09.01.2013; Akt Emërimit me Nr. 017 të datës 09.01.2013; Kontratë e Marrëdhënies së punës me Nr. 157/2010 të datës 06.08.2010; Kontratë e marrëdhënies së punës DBF-003/2010 e datës 02.06.2010; Kontratë e Marrëdhënies së punës me Nr. Ref: 021/2008 e datës 08.08.2008; Kontratë e përkohshme e punës me Nr.prot:33/2008 e datës 08.05.2008; Deklaratë nënë betim e datës 19.06.2015; Vërtetimi i datës 06.02.2012; Certifikatë mbi përvojën e punës e datës 13.11.2008; Aktvendim nga Kryetari i Shoqatës Bashkimi; Certifikatë mbi përvojën e punës i datës 11.09.1997; Konfirmimin e datës 20.02.2012; Diplomë e datës 26.10.2020; Vendimin Ref. Nr. 216-2306 i datës 15.04.2022; Diplomën

me Nr. 106 të datës 14.01.2009; Diplomën me Nr. 3691 të datës 07.04.2021; Certifikatën për periudhën 01-05.03.2004; Certifikatën për periudhën 02.02-22.09.2004; Certifikatën dhjetor 2015; Certifikatën e datës 12.03.2009; Certifikatën për periudhën 01.02.2004 deri 27.04.2005; Certifikatën për periudhën 04.10-13.12.2002; Certifikatën për periudhën 02-03.12.2014; Certifikatën e datës 30.09.2013; Certifikatën për periudhën 22-24.04.2014; Certifikatën nga The Federal Republik of Germany; Referencë korrik 2005; Shkresë e datës 12.12.2005; Formuari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i datës 31.01.2020, 30.10.2019, 21.12.2017; Aktvendimin E.nr.1291/2012 i Gjykatës Komunale në Prishtinë; Aktvendimin E.nr.1219/2012 i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 17.12.2012; Vendimin A.nr.417/2020 i Këshillit; Vendimin A/02/203/2015 i Këshillit; Vendimin A 02/79/2012 i Këshillit; Certifikatën trajnimi dhjetor 2022; Certifikatën për periudhën 01.10-13.12.2002; Certifikatën për periudhën 01.02.-22.09.2004; Certifikatën prill 2005-qershor 2006; Certifikatën për periudhën 26-28.10.2004; Certifikatën mars 2003; Certifikatën 24.01.2000; Certifikatën për periudhën 23.03-19.04.2006; Certifikatën për periudhën 07.09-12.12.2005; Certifikatën për periudhën 28.04-26.05.20045; Certifikatën e datës 07.09.2007; Certifikatën e datës 12.04.2003; Certifikatën e datës 12.04.2003; Certifikatën e datës 04.05.2015; Certifikatën për periudhën 01.02-14.03.2006; Certifikatën për periudhën 20.10-08.12.2005;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, *Sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme gjegjësisht në pozitën e Drejtorit për Diplomaci Ekonomike. Me tej nga shkresat e lëndës rezultojnë se me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç'rast si pasojë e bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve për pozita të caktuara.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rezultojnë se Zëvendësueseje e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar vetëm si Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjën VPD Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi është njoftuar individualisht lidhur me procesin e ristrukturimit përmes shkresës më numër 104/2022 të datës 21.03.2022 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore, me sqarimin se pozita e ankuesit ekziston edhe me Rregulloren e re mirëpo që ka ndryshim lidhur me kushtet për këtë pozitë të punës që kanë të bëjnë me kualifikimet e posaçme, andaj ankuesi do i nënshtrohet procesit të transferimit sipas nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit të datës 14.04.2022, ka konstatuar së ankuesi Shkëlzen Morina në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Diplomaci Ekonomike, nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale për këtë pozitë, dhe ka propozuar sistemin e ankuesit në një pozitë të lirë ku ankuesi plotëson kërkesat e posaçme.

Ankuesi më datë 10.08.2022 kishte parashtruar ankesë me numër protokolli 4633/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli më vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, më Raportin e Veçantë të Punës të datës 31.10.2022, ka konstatuar së ankuesi me datë 27.10.2022 ka dërguar preferencat për sistemim në pozitën Drejtor i Departamentit par Diplomaci Publike dhe Drejtor i Departamentit për Nato dhe Politika të Sigurisë. Komisioni i Ristrukturimit bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi ka konstatuar se ankuesi ka plotësuar kriterin e arsimimit dhe përvojës së punës, mirëpo nuk ka plotësuar kriterin lidhur me kualifikimet e veçanta formale dhe po ashtu i njëjti nuk ka plotësuar as kualifikimet e veçanta edhe për pozitën tjera të lira të kategorisë së mesme drejtuese, si Drejtor i Departamenti të Protokollit të Shtetit dhe Drejtor i Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate. Rrjedhimisht sipas Komisionit të Ristrukturimit, ankuesi ka ofruar dëshmi-certifikatë të gjuhës gjermane po që njohja e kësaj gjuhe nuk kërkohet për asnjërën nga pozitën e lira dhe që institucioni i cili ka lëshuar këtë certifikatë si i tillë nuk figuron të jetë i akredituar nga Autoriteti Kosovar i Kualifikimeve. Komisioni i Ristrukturimit në Raportin e Veçantë të Punës të datës 31.10.2022 propozon që ankuesi meqenëse nuk plotëson kriteret për asnjërën nga pozitën e lira të nivelit të mesëm drejtues, të transferohet në një institucion tjetër të Shërbimit Civil, duke rekomanduar që ankuesi të sistemohet në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Bazuar në propozimi e Komisionit të Ristrukturimit, Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.148/2022 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se procedura e transferimit është bërë në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse nuk janë plotësuar kushtet për ristrukturimin e pozitës së ankuesit, ngase bashkimi i dy institucioneve nuk mund të kualifikohet si ristrukturim. Me tej ankuesi thekson së me rastin e transferimit të tij nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 13 paragrafi 1 i Rregullores(QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse ndryshimet e vendit të punës nënkuptojnë ndryshime thelbësore të detyrave dhe përgjegjëseve andaj edhe ndryshimi i kushtit të njohjes së gjuhës nga B1 në C1 dhe C2 është bërë pasi që ankuesit i janë kërkuar certifikatat i cili posedon certifikatë të njohjes së gjuhës të nivelit B1. Po ashtu ankuesi shton së Komisioni i Ristrukturimit ka cenuar statusin shtesë të ankuesit duke mos i marrë parasysh nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht statusin e veçantë të nëpunësit civil pasi që të njëjti sipas legjislacionit për shërbim të jashtëm mbajnë grada diplomatike, andaj, stafi i Ministrisë së Punëve të Jashtë është dashur të kenë përparësi në sistemim para stafit të ministrisë tjetër të cilët nuk kanë grada dhe kualifikomë të veçanta. Tutje, ankuesi deklaron së Komisioni i Ristrukturimit nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores(QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë sepse në rastin e ankuesit nuk është bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemimit të Pikëzimit që do të mundësonte vlerësimin me pikë të kriteret për prioritet të transferimit, por Komisioni bazohet në Udhëzuesin

Nr.02/2022 për Procesin Riorganizim të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e nëpunësve pas ristrukturimit i miratuar me Vendimin e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, akt ky i paligjshme pasi që është nxjerrë nga personi jo kompetent, ndërsa kompetent për të nxjerr akt nën ligjor është Qeveria sipas nenit 54 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Propozon që Këshillit të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin me numër 148/2022 të datës 10.11.2022 të zëvendësueses së Drejtores së DMZP-së, si dhe Rekomandimin me numër protokollit 1620 të datës 01.11.2022 të Komisionit të Ristrukturimit dhe të obligoj Zëvendësuesen e Drejtores së DMZP-së, që të nxjerrë vendim për sistemimin e ankuesit në Pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike duke i kompensuar të gjitha pagat dhe beneficionet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës sipas Aktit të Emërimit Nr.07/2020 të datës 11.11.2020 bderi në zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit së procedura e transferimit është bërë në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse nuk janë plotësuar kushtet për ristrukturimin e pozitës së ankuesit, ngase bashkimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës nuk mund të kualifikohet si ristrukturim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, vlerëson së bazuar në frymën e këtyre normave juridike, ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizmit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit ka pasur ndryshime të vendeve të punës, shkurtime të vendeve të punës apo ndryshimit të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji konstaton se si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, është bërë riorganizimi i këtyre dy ministrive i materializuar me Rregullores Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe si rrjedhojë e riorganizimit ka pas shuarje të pozitive të caktuara të punës, krijim të pozitive të reja të punës si dhe ndryshime të kriterëve për pozita të caktuara, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Përkritazi me pretendimin e ankuesit së ndryshimet e vendit të punës nënkuptojnë ndryshime thelbësore të detyrave dhe përgjegjësive, Kolegji i Këshillit ka analizuar nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: "1. Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurrtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës", e mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ristrukturim të institucionit përveç ndryshimeve të detyrave dhe përgjegjësive kemi edhe në rast të ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. E në këtë kontekst Kolegji duku u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të miratuar nga DMZP-ja lidhur me pozitën e punës Drejtori i Departamentit të Diplomacisë Ekonomike (pozitë të cilën e ka mbajtur ankuesi para ristrukturimit) ka pas ndryshime të kriterëve të punës përkatësisht janë përcaktuar kriter shtesë lidhur me kualifikimet e veçanta duke vendosur si kriter njohjen e gjuhës angleze.

Nuk qëndron pretendimi ankimor së Komisioni i Ristrukturimit ka cenuar statusin shtesë të ankuesit duke mos e marrë parasysh nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse nga shqyrtimi i provave të lëndës nuk është vërtetuar fakti se ankuesi ka pas të fituar ndonjë

gradë diplomatike, dhe që në vlerësimin e Kolegjit, gradat diplomatike paraqesin kriter shtesë të vlerësimit për nëpunësit që kanë përvetësuar grada diplomatike në pajtim me legjislacionin e shërbimit të jashtëm.

Duke ju referuar pretendimit ankimor së Komisioni i Ristrukturimit është bazuar në Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin Riorganizim të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, Kolegji bazuar në administrimin e shkresave të lëndës nuk ka gjetur dëshmi së Komisioni i Ristrukturimit ka marrë për bazë Udhëzuesin në fjalë. Rrjedhimisht në Vlerësimin e Kolegjit Udhëzuesi Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimi të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve Civil pas Ristrukturimit, ka karakter udhëzues dhe pasqyron metodologjinë që duhet ndjekur në procesin e ristrukturimit gjegjësisht sistemimit të stafit. Ndërlidhur me këtë, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka konstatuar së Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Brendshme ka miratuar Metodologjinë e vlerësimit dhe sistemit të pikëzimit për kriteret e vlerësimit, dhe së në vlerësimin e Kolegjit kriteret e vlerësimit janë në pajtim me nenin 14 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, më të cilin është përcaktuar se: *“..5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet. 6. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter”*.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar si me lartë, vlerëson se Komisioni i Ristrukturimi me rastin e përgatitjes së raportit me numër protokollit 1620 të datës 01.11.2022 në raport me ankuesin, ka vepruar në pajtim me ligjin material, sepse në mbështetje të provave të lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.07/2020 të datës 02.07.2020 ka qenë i emëruar në pozitën e punës *“Drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike”* në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pozitë e përcaktuar edhe me Rregulloren Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo për pozitën e njëjtë kanë ndryshuar kriteret e përgjithshme formale. Rrjedhimisht sipas përshkrimit të detyrave të punës të miratuar me datë 17.04.2015, si kriteret e pranimit për pozitën Udhëheqës i Departamentit për Diplomaci Ekonomike, kanë qenë: *diplomë universitare, 7 vite përvojë profesionale përfshirë se paku 4 vite në pozitë drejtuese, ndërsa bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të miratuara pas hyrjes në fuqi të Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë, për pozitën e punës Udhëheqës i Departamentit për Diplomaci Ekonomike si kriteret janë vendosur: Arsimit: *Diplomë/a të studimeve universitare, në lëmin e Ekonomisë, të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Në kuptim të plotësimin të kriterëve për këtë pozitë të punës, Kolegji bazuar në shqyrtimin e dosjes personale të ankuesit ka gjetur së i njëjti lidhur me këtë pozitë të punës ka plotësuar kriterin e arsimit dhe përvojës së punës por jo edhe kualifikimet e veçanta lidhur me njohjen e gjuhës angleze, gjegjësisht ankuesi lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja posedon certifikatën e lëshuar nga Shkolla e Gjuhëve të huaj “ The Cambridge School” të datës 20.04.2010 lidhur me**

përfundimin e nivelit Intermediate- B1 të gjuhës angleze, pra ankuesi nuk posedon dëshmi lidhur me njohje të gjuhës angleze të nivelit C1-C2.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ka analizuar edhe kriteret lidhur me pozitat e kategorisë së mesme drejtuese që kanë qenë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përfundim të ristrukturimit gjegjësisht për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: *"Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare në Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze., për pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge, për pozitën Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë si kritere janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge, për pozitën Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit si kritere të përcaktuar janë: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare në Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"* për pozitën Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare tek kualifikimet e posaçme formale kërkohet: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Shkenca Politike, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e ndonjë prej gjashtë(6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura, Rrjedhimisht Kolegji vëren së ankuesi për asnjërën nga pozitat e lartshënuara nuk plotëson kriterin lidhur me njohje të gjuhëve të huaja.

Përkitazi me ligjshmërinë e sistemimit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Administratë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, Kolegji vlerëson se Vendimi me Nr.148/2022 i datës 10.11.2022 i Zëvendësueses të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është nxjerrë në pajtim me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse bazuar në vlerësimin e

shkresave të lëndës është plotësuar kriteri i transferimit në kategori të njëjtë si dhe kriteri i plotësimit të kushteve dhe kualifikime për pozitën përkatëse.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1059/2022

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit më autorizim Av. [REDACTED]
- Drejtorit të DMZP-së;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së